



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Fondi për Sigurime Shëndetësore - Fond za zdravstveno osiguranje - Health Insurance Fund

FONDI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE



RAPORT VJETOR I PUNËS

2024

Email: fssh.info@rks-gov.net

Tel: +38 200 80 747

Website: fssh.rks-gov.net

Adresa: Lakërishtë, Rr. Tirana, Prishtinë 10000, Kosovë

TABELA E PËRMBAJTJES

BORDI DREJTUES	3
Misioni, Vizioni, Vlerat	4
Përmbledhje Ekzekutive	6
Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe Auditimi	8
Divizioni Ligjor	9
Komunikimi dhe Raportimi	9
Burimet Njerëzore	10
Divizioni për Informim dhe Bashkëpunim	10
 SHËRBIMET SHËNDETËSORE	 11
Trajtimet mjekësore jashtë institucioneve shëndetësore publike (TMJIShP)	11
 SHËRBIMET FARMACEUTIKE	 16
 RAPORT FINANCIAR	 17
Obligimet / Detyrimet Kontigjente	19
Pasuritë	20
Prokurimi	20
Divizioni për TI dhe shërbime logjistike	21
Barazimi me institucione shëndetësore private	21
Shërbimet e informacionit	22
 SFIDAT	 23

BORDI DREJTUES


Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-249 për Sigurimet Shëndetësore, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 18/153 të datës 26.07.2023 ka emëruar Bordin Drejtues të Fondit.

Referuar kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Sigurime Shëndetësore Nr. 04/L-249 dhe me Statutin e Fondit, Bordi Drejtues ka mbikëqyrë veprimtarinë e Fondit, ka shqyrtuar dhe aprovuar raportet e rregullta dhe me transparencë ka siguruar që sistemet e kontrollit të brendshëm të jenë në pajtim me parimet e Menaxhimit të Financave Publike në sektorin publik.

Gjatë vitit 2024, në takimet e rregullta, Bordi Drejtues përveç mbështetjes së FSSH-së në procesin e kompletimit të infrastrukturës ligjore dhe sigurimin e buxhetit shtesë për Programin e TMJIShP, ka realizuar edhe aktivitetet si në vijim:

- Aprovimi i Planit të punës së Fondit për vitin 2024;
- Aprovimi i Raportit vjetor të Fondit për vitin 2023;
- Përzgjedhjen e Drejtorit të Fondit si dhe
- Shqyrtimin e raporteve periodike të aktiviteteve të FSSH-së.

Bordi Drejtues i Fondit mbetet i angazhuar në realizimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësi të cilat i janë përcaktuar me Ligjin për Sigurime shëndetësore Nr. 04/L-249 dhe Statutin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Struktura organizative e FSSH-së është e përcaktuar me Rregulloren Nr.04/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.



Vlerat themelore të Fondit



Synimet

Synojmë që të kemi zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, duke u mbështetur në punonjës kompetentë dhe të orientuar drejtë rezultateve.

Transparenca dhe llogaridhënia

Të jemi të besueshëm, të hapur dhe të afërt. Vendimmarrja të jetë transparente dhe e vëmendshme ndaj të tjerëve.



Bashkëpunimi

Te krijojmë një atmosferë besimi brenda institucionit tonë dhe në marrëdhëniet me partnerët dhe klientët tanë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ligji për Sigurim Shëndetësor Nr. 04/L-249, përcakton se mbikëqyrja e veprimtarisë dhe ligjshmërisë së aktiviteteve në Fond realizohet nga ana e Bordit Drejtues, i cili shqyrton raportet e rregullta vjetore dhe tre (3) mujore me deklaratën financiare, raportet e auditimit si dhe raportet plotësuese mbi aktivitetin e Fondit. Bazuar në këtë, është hartuar raporti vjetor i FSSH-së, së bashku me përmbledhjen financiare si dhe raportet plotësuese mbi aktivitetet e realizuara të FSSH-së. Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh të gjitha burimet me të cilat disponon Fondi për Sigurim Shëndetësor, përfshirë këtu burimet njerëzore dhe ato financiare.

Deri në fillimin e mbledhjes së kontributeve, FSSH financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe i nënshtrohet respektimit të obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike dhe Rregullave të Thesarit. Gjatë vitit 2024 FSSH-së ka realizuar një sërë aktivitetsesh lidhur me hartimin e bazës ligjore, sigurimin e buxhetit shtesë për programin e TMJISHP dhe ngritjen e nivelit dhe transparencës. FSSH ka kontribuar në mënyrë aktive në hartimin e Ligjit të ri për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor, plotësim ndryshimin e UA për TMJISHP, hartimin e politikave (strategjinë sektoriale të shëndetësisë) dhe dokumenteve tjera në interes të sektorit të shëndetësisë. Po ashtu, janë përgatitur para draftet për kontaktimin e shërbimeve shëndetësore dhe farmaceutike.

Fondi ndër vite është përballur me mungesë të thekësuar të buxhetit në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Mbështetur nga MSh dhe MFPT, është arritur që FSSH të ketë buxhet shtesë në këtë kategori (15 milionë euro në vitin 2023 dhe 4 milionë euro në vitin 2024), buxhet ky i cili ka kontribuar direkt në zvogëlimin e vonesave në marrjen e shërbimeve shëndetësore nga Programi për TMJISHP si dhe zvogëlimin e obligimeve të bartura ndër vite.

Sa i përket shpenzimit të buxhetit, nga 12,723,112€ sa ishte buxheti final, FSSH ka shpenzuar 12,637,701€ apo shprehur në përqindje 99.32%. Referuar ndarjeve buxhetore për vitin 2025, kemi rritje të buxhetit për Programin për TMJISHP, duke arritur vlerën prej 10mil€, e që paraqet një rritje substanciale në përafrimin e nevojave reale të këtij programi. Gjatë këtij viti, FSSH ka arritur të kthej 661,072.76€ mjete të lira të identifikuara nga procesi i barazimeve financiare me institucionet shëndetësore private, me të cilat FSSH ka kryer barazimet financiare.

Mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë, FSSh në vitin 2024 ka filluar procesin e digjitalizimit të plotë të procesit administrativ dhe vendimarrës në Programi për TMJIShP. Grupi punues i përbërë nga anëtarët e tri institucioneve (MSh, FSSh dhe QKUK) ka hartuar termat e referencës dhe se në vitin 2025 pritet fillimi i implementimit të këtij sistemi i cili si i tillë, do të kontribuon në mbrojtjen e të dhënave sensitive dhe në respektimin e standardeve të larta të privatësisë dhe sigurisë.

Implemetimi i sigurimeve shëndetësore është projekt multisektorial, funksionalizimi i të cilit varet nga shumë hisedarë. Me gjithë të arriturat e theksuara më lart, FSSh ka edhe shumë sfida në realizimin e objektivave drejtë funksionalizimit të plotë të sigurimeve shëndetësore, të cilat nuk ndërlidhën vetëm me buxhetin dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore por edhe me ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

Raporti Vjetor i FSSh për vitin 2024, në mënyrë të strukturuar paraqet të gjitha aktivitetet e realizuara brenda këtij viti. Për të qenë sa me transparent, kemi shpalosur detaje të mjaftueshme për të gjitha aktivitetet e realizuara kundrejt detyrave dhe përgjegjësisë të deleguara.

SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE AUDITIMI

Gjatë periudhës tranzitore dhe deri në fillimin e mbledhjes së premieeve, FSSH financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe i nënshtrohet respektimit të obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike dhe Rregullave të Thesarit. Proceset e rishikuara në kuadër të FSSH-së mundësojnë kontrolle efikase për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e objektivave të FSSH-së. Në vitin 2024 përveç hartimit dhe monitorimit të regjistrit të rreziqeve, FSSH rëndësi të veçantë i ka kushtuar implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) duke formuar Komisionin për Përcjelljen e Progresit në Implementimin e Rekomandimeve të dhëna dhe si rrjedhojë ka arritur të implementojë të gjitha rekomandimet përkatëse (5).

Sa i përket auditimit të brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përmbushur në mënyrë të plotë të gjitha detyrimet e saj ligjore dhe procedurale, duke raportuar rregullisht pranë Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Përveç përmbushjes së këtyre obligimeve ligjore, NJAB ka realizuar auditimet e brendshme të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2024. Këto auditime janë përqendruar në fusha kyçe të menaxhimit dhe administrimit, me qëllim forcimin e kontrolleve të brendshme. Auditime të Brendshme të realizuara në vitin 2024 janë:

- Auditimi i Divizionit të Personelit;
- Auditimi i Programit të Trajtimit Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Auditimi i Barazimeve Financiare për Pagesat e Realizuara në Programin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Auditimi i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Auditimet e brendshme kanë rezultuar me ofrimin e rekomandimeve të rëndësishme për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe për rritjen e efikasitetit në njësitë përkatëse. Menaxhmenti, pas pranimit të raporteve të auditimit, ka hartuar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, ku përveç aktiviteteve të parapara, janë përcaktuar edhe afatet kohore dhe zyrtarët përgjegjës për implementimin e këtyre rekomandimeve.

DIVIZIONI LIGJOR

Divizioni ligjor luan një rol kyç në funksionimin e duhur të institucionit dhe sigurinë juridike të aktiviteteve të tij. Ky divizion siguron që veprimet dhe vendimet e institucionit të jenë në përputhje me ligjin dhe të mbrojnë interesat publike dhe ato të qytetarëve, në funksion të ofrimit të shërbimeve profesionale me qëllim të realizimit të aktiviteteve të parapara nga Fondi.

Gjatë kësaj periudhe, divizioni ligjor ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Hartimin e akteve normative ku janë hartuar dy rregullore: Rregullorja për Disiplinën në Punë për të Punësuarit në FSSH dhe Rregullorja për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.
- Asistimi i Avokaturës Shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë në rastet kur Fondi ka qenë palë ndërgjyqësore. Janë pranuar (shtatëmbëdhjetë) 17 Padi, prej të cilave, (gjashtëmbëdhjetë) 16 Padi me kërkesë për kompensimin e mjeteve për Trajtim Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, ndërsa (një) 1 Padi me kërkesë për kompensimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për barnat që nuk janë pjesë e listës së barnave esenciale.
- Ofrimi i sqarimeve të nevojshme për Avokaturën Shtetërore për përgatitjen e përgjigjeve në padi të ushtruar ndaj Fondit. Gjatë kësaj periudhe, janë pranuar dhe trajtuar gjithësej (njëqind e dyzet e nëntë) 149 Ankesa kundër Vendimeve të Bordit për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP), ku (njëqind e tridhjetë e katër) 134 prej tyre janë refuzuar ndërsa (pesëmbëdhjetë) 15 Ankesa janë aprovuar, me ç' rast është obliguar Bordi për TMJISHP që të bëjë shqyrtime shtesë dhe të nxjerr Vendim bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

KOMUNIKIMI DHE RAPORTIMI

Komunikimi dhe raportimi janë dy aspekte thelbësore në menaxhimin e suksesshëm të FSSH-së, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e shërbimeve, sigurimin e transparencës dhe disponueshmërisë së informacionit për qytetarët.

Komunikimi efektiv ndihmon në koordinimin e punës brenda Fondit, duke lehtësuar marrëdhëniet ndërmjet departamenteve dhe punonjësve. Në funksion të organizimit dhe menaxhimit efikas, drejtori i Fondit mban takime të rregullta me udhëheqësit e departamenteve, ku diskutohet dhe raportohet për aktivitetet operative të realizuara si dhe ato të planifikuara.

BURIMET NJERËZORE

Divizioni i Personelit, zhvillon linjat e veprimit dhe planet e autoritetit të punësimit për menaxhimin e personelit në mënyrë që nëpunësit të ushtrojnë detyrat në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Përpos kësaj ky divizion zhvillon edhe aktivitete tjera lidhur me rekrutimin e nëpunësve, vlerësimin si dhe aktivitete tjera të përcaktuara me rregulloren e brendshme për organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Është hartuar plani vjetor i trajnimeve për vitin 2024-2025, në bazë të cilit janë planifikuar trajnime bazike dhe të avancuara. Qëllimi i këtyre trajnimeve është që personeli i Fondit të ruajë njohuritë rreth proceseve të punës si dhe të avancojë njohuritë profesionale (kompetencat) përmes pjesëmarrjes në trajnime profesionale.

Gjatë vitit 2024, përveç procesit të përzgjedhjes së Drejtorit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, FSSh nuk ka zhvilluar procedura tjera të rekrutimit. Numri i të punësuarve në fund të vitit 2024 ishte 39.

DIVIZIONI PËR INFORMIM DHE BASHKËPUNIM

Aktivitetet e Divizionit për Informim dhe Bashkëpunim janë thelbësore në funksionimin efikas të FSSh-së, ku përmes një komunikimi efektiv, bëjnë të mundur shpërndarjen e informacioneve në mënyrë të saktë dhe të shpejtë. Gjithashtu, divizioni luan një rol kyç në informimin dhe sinkronizimin e duhur të aktiviteteve si brenda, ashtu edhe jashtë FSSh-së përmes aktiviteteve si në vijim:

- Komunikimi me media, përcjellja e informacioneve për të gjitha aktivitetet e Fondit, më qëllim të komunikimit dhe informimit, përmes kanaleve të shkruara dhe elektronike;
- Përgatitja e informacioneve të ndryshme për shtyp, seleksionimi dhe arkivimi i shkrimeve nga gazetat, revistat dhe shkrimet e ndryshme që kanë të bëjnë me Fondin;
- Publikimi i vazhdueshëm i dokumenteve me rëndësi për Fondin dhe konkurseve në WEB faqen e institucionit;
- Publikimi i raporteve periodike në web faqen dhe rrjetet sociale të Fondit rreth numrit të aplikimeve, lëndëve të shqyrtuara nga Bordi, komisioni i Ankesave si dhe referimeve nga Klinikat e QKUK-së.

- Trajtimi i të gjitha kërkesave (pyetjeve) të pacientëve që kërkojnë mbështetje financiare nga programi për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike duke siguruar se rrjedhja e informacionit të jetë sa më transparente;
- Monitorimi i vazhdueshëm i Planit të integritetit të FSSH-së;

SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Departamenti për Shërbime Shëndetësore në FSSH luan një rol kyç në zhvillimin e politikave shëndetësore dhe standardeve, duke ndihmuar në krijimin e një sistemi shëndetësor më efektiv dhe të qëndrueshëm.

Në kuadër të kësaj periudhe Departamenti për Shërbime Shëndetësore përveç aktiviteteve të prezentuara në vijim, ka kontribuar në mënyrë aktive në grupet punuese të themeluara nga Ministria e Shëndetësisë në hartimin e politikave si dhe kostimin e tyre, strategjive, akteve ligjore dhe nënligjore.

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe përfshijnë përgatitjen e drafteve fillestare të Rregulloreve dhe formave të kontratave si:

- Kushtet e përgjithshme të kontratës për Kujdesin Parësor Shëndetësor,
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Shërbimin Specialistik-Konsultativ,
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Kujdesin Spitalor.

TRAJTIMET MJEKËSORE JASHTË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE PUBLIKE

Programi TMJISHP është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kushtet kur Institucionet Shëndetësore Publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen në institucione shëndetësore private brenda ose jashtë vendit. Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me Udhëzim Administrativ 03/2023 në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program.

Në këtë program, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, kanë aplikuar 1185 pacientë. Prej tyre, 368 raste urgjente dhe 817 raste të rregullta. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithësej 1626 aprovime (përfshirë edhe aplikimet e viteve paraprake).

Tabela 1, figura 1: Kërkesat dhe lëndët e aprovuara për periudhën Janar - Dhjetor 2024 për programin TMJISHP.

Nr.	Lloji i aplikimit/përshkrimi	2024	%
1	Raste të rregullta	817	68.9
2	Raste urgjente	368	31.1
3	Nr. total i Aplikimeve	1185	100.0
4	Vendimet e Bordit për TMJISHP	1626	






Figura 2: Aplikimet sipas muajve Janar - Dhjetor 2024



Nëse i referohemi aplikimeve në baza mujore, vërejmë se në muajin Prill ishin 126 aplikime, në muajin Maj 123 aplikime, ndërsa numrin më të vogël të aplikimeve e kishim në muajin Shtator me gjithsejtë 55 aplikime. Mesatarja e aplikimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2024 ishte 99 aplikime/muaj.

Tabela 2, figura 3: Aplikimet/Indexi sipas tre muajve 2024:

Tre Mujori	Numri	Index
TM1	322	100.0
TM2	338	105.0
TM3	231	71.7
TM4	312	96.9



REFERIMET


Klinikat si Mjekësia Nukleare, Pediatria, Klinika e Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitimit, Oftalmologjia, Radiologjia dhe Ortopedia kanë paraqitur numrin më të madh të referimeve në Programin për TMJIShP për periudhën raportuese Janar - Dhjetor 2024.

Në tabelën e mëposhtme fillimisht është paraqitur trendi i referimeve në bazë të klinikave, përfshirë numrin e tyre për periudhën raportuese si dhe klinikat me koston më të lartë financiare në raport me këto referime.

Tabela 2: Numri i referimeve sipas klinikave:

1	Endokrinologji	2
2	Gastrologji	11
3	Gjinekologji	7
4	Hematologji	67
5	Infektivë	1
6	Kardiokirurgji	8
7	Kardiologji	10
8	Kirurgji Abdominale	5
9	Kirurgji maksillofaciale	1
10	Kirurgji Plastike	9
11	Kirurgji Torakale	22
12	Kirurgji Vaskulare	14
13	Kirurgji e Fëmijëve	4
14	Klinika e Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitim	117
15	Mjekësi Nukleare	223
16	Nefrologji	46
17	Neonatologji	19
18	Neurokirurgji	22
19	Neurologji	38
20	Oftalmologji	88
21	Onkologji	3
22	Ortopedi	79
23	Otorinolaringologji	50
24	Pediatri	195
25	Pulmologji	10
26	Radiologji	80
27	Urologji	54
		1185

Figura 3: Klinikat me numrin më të madh të referimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2024




Nga gjithsejtë 1185 aplikime, 6 klinikat e prezantuara në diagram përbejnë 782 aplikime (apo 66% të total aplikimeve).

Figura 4: Klinikat me vlerën financiare të përafërt më të lartë në bazë të referimeve për vitin 2024:



Nëse i referohemi gjinisë/moshës, nga gjithsej 1185 aplikime, 674 prej tyre rezultojnë meshkuj ndërsa 511 femra. Prej tyre 849 të rritur dhe 336 nën moshën 18 vjeç.

Figura 5: Aplikimet në bazë të gjinisë/moshës:



SHËRBIMET FARMACEUTIKE

Departamenti për Shërbime Farmaceutike në FSSH, në kuadër të së cilit funksionon Divizioni për analizë, planifikim dhe menaxhim të kontratave si dhe Divizioni për çmime dhe rimbursim, luan një rol kyç në zhvillimin dhe krijimin e politikave dhe protokolleve për përdorimin e barnave, duke ndihmuar në menaxhimin e burimeve dhe optimizimin e shërbimeve.

Në kuadër të kësaj periudhe Departamenti për Shërbime Farmaceutike përveç aktiviteteve të prezentuara në vijim, ka kontribuar në mënyrë aktive në grupet punuese të themeluara nga Ministria e Shëndetësisë në hartimin e politikave si dhe kostimin e tyre, strategjive, akteve ligjore dhe nënligjore.

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe përfshijnë përgatitjen e drafteve fillestare të Rregulloreve dhe formave të kontratave si:

- Përgatitja e draftit fillestar UA për kontraktim të barnatoreve;
- Përgatitja e draftit fillestar të kontratës me barnatore;
- Pjesëmarrje aktive në Bordin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJShP) ;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Divizionin e Farmacisë pranë MSh-së rreth furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Lista e Barnave Esenciale për nevojat e Institucioneve Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor (KPSH, KDSH dhe KTSH);
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Institucionet relevante, përfshirë këtu Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) si dhe Odën e Farmacistëve të Kosovës (OFK) etj.

RAPORT FINANCIAR



Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, buxheti i ndarë për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore është 8,877,671.00 €.

Tabela 3. Ndarjet buxhetore të Fondit për vitin 2024

Kategoritë ekonomike	Administrata	TMJISHP	Gjithsej buxheti për vitin 2024
Paga dhe Shtesa	375,854		413,806
Mallra dhe Shërbime	476,817		500,000
Shpenzime komunale	25,000		25,000
Subvencionet dhe transfere		8,000,000	8,000,000
Shpenzimet kapitale	-		-
Gjithsej	€ 877,671.00	€ 8,000,000.00	€ 8,938,806.00

Nga Tabela nr. 1 mund të shihet se nga gjithsej buxheti fillestar për vitin 2024, vlera prej 8,000,000€, ose 89.50 % e totalit të buxhetit ishte ndarë për subvencione dhe transfere, përkatësisht për programin për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, ndërsa pjesa tjetër për shërbimet administrative të Fondit.

Tabela 4. Shpenzimet në raport me buxhetin final sipas kategorive ekonomike për vitin 2024

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti final	Shpenzimet 2024	Realizimi i buxhetit në %
Paga dhe Shtesa	375,854	421,295	421,295	100%
Mallra dhe Shërbime	476,817	276,817	240,543	87%
Shpenzime komunale	25,000	25,000	16,685	67%
Subvencionet dhe transfere	8,000,000	12,000,000	11,958,533	99.65%
Shpenzimet kapitale	-	-	-	
Gjithsej	8,877,671€	12,723,112€	12,637,701€	99.32%

Paga dhe shtesa - Buxheti fillestar i aprovuar ishte 375,854 €, mirëpo në buxhetin final kjo kategori ishte rritur në 421,295€. Në fund të vitit buxheti i realizuar ishte 421,295€, ose shprehur në përqindje në 100%;


Mallra dhe shërbime - Buxheti fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 476,817€, mirëpo me vendim ky buxhet ishte ulur për 200,000€, duke reduktuar vlerën e buxhetit final në 276,817€. Buxheti final i shpenzuar ishte 240,543€, ose shprehur në përqindje në 87%;

Shpenzimet komunale - Buxheti fillestar/final i aprovuar për këtë kategori ishte 25,000€. Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ekonomike ishte 16,685€, ose shprehur në përqindje 67%;

Subvencione dhe transfere - Buxhetin fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 8,000,000€, të cilit, me Vendim të Qeverisë në fund të vitit i janë shtuar edhe 4,000,000€, duke bërë që buxheti total i alokuar për këtë kategori të arrijë vlerën 12,000,000€. Buxheti final i shpenzuar ishte 11,958,533€, ose shprehur në përqindje 99.7%; dhe

Shpenzimet kapitale - Me ligjin për ndarje buxhetore, FSSH nuk ka të buxhetuar projekte kapitale.

Figura 6. Shpenzimet në raport me buxhetin final sipas kategorive ekonomike për vitin 2024




OBLIGIMET / DETYRIMET KONTIGJENTE

Referuar faktit se kategoria subvencione dhe transfere (Programi për TMJISHP) historikisht ka qenë e nën-buxhetuar në raport me kërkesat për TMJISHP, Qeveria e Republikës së Kosovës vetëm në dy vitet e fundit ka alokuar buxhet shtesë në vlerë prej 19 mil € (2023 - 15mil € dhe 2024 - 4mil€), buxhet ky i cili ka ndikuar direkt në uljen e detyrimeve të akumuluar ndërr vite në Programin e TMJISHP, detyrime këto të cilat deri në fillim të vitit 2023 kishin arritur vlerën prej 32mil€, ndërkohë që vlera e obligimeve të mundshme të raportuara në Ministrinë e Financave për vitin 2024 tashmë është ulur në 14mil€.

Tabela 5. Obligimet / detyrimet kontigjente:

Subvencione dhe Transfere - Obligimet dhe Detyrimet Kontingjente	Obligimet 2024
Obligime me fatura të raportuara në kategorinë Subvencione	2,701,567.98
Vendimet e aprovuara nga Bordi në pritje të faturave	3,615,641.38
Fletë-zotimet	6,269,613.52
Lende të rregullta në pritje për shqyrtim nga Bordi për TMJISHP	1,902,479.61
Gjithsej	€ 14,489,302.49

Figura 7. Obligimet / detyrimet kontigjente:



PASURITË

Për vitin 2024, janë kryer regjistrimet e përgjithshme të pasurisë jo financiare dhe janë bërë emërimet e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare dhe Vlerësimin e Pasurisë në FSSH, të cilët pas procesit të verifikimit/numërimit fizik të pasurisë dhe vlerësimit të pasurisë, kanë hartuar raporte të cilat janë krahasuar me regjistrat e pasurive jo financiare duke identifikuar dhe eliminuar diferencat.

PROKURIMI

Sipas marveshjes FSSH - MSh, shërbimet e prokurimit për nevojat e FSSH-së në vitin 2024 janë realizuar nga Divizioni i Prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Gjatë kësaj periudhe janë kontraktuar shërbimet e mirëmbajtjes dhe sigurimit për nevojat e FSSH-së si dhe janë shfrytëzuar kontratat e centralizuara nga AQP.

DIVIZIONI PËR TI DHE SHËRBIME LOGJISTIKE

Fondi aktualisht ka vetëm një zyrtar të TI-së i cili ofron mbështetje teknike për stafin dhe administrimin e rrjeteve dhe sistemeve që posedon FSSh. Arkitektura harduerike që FSSh ka ndërtuar në ambientet e ASHI ka shërbyer si një bazë e rëndësishme për integrimin e sistemeve të informacionit. Gjatë vitit 2024, FSSh nuk ka të raportuar/regjistruar asnjë incident të sigurisë në sistemet e veta për këtë periudhë. Kjo dëshmon një nivel të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave, megjithëse është evidente mungesa e personelit të mjaftueshëm të TI-së.

Divizioni i Logjistikës përveç aktiviteteve të rregullta, ka menaxhuar dhe mirëmbajtur infrastrukturën fizike të FSSh-së. Sa i përket arkivimit dhe digjitalizimit, në vitin 2024, pos protokolimit të 7,303 lëndëve, divizioni ka vazhduar me aktivitetin e skenimit të lëndëve të bartura nga Ministria e Shëndetësisë, aktivitet ky që pritet të vazhdoj deri në krijimin e kopjes elektronike për të gjitha lëndët e bartura nga MSh në arkivën qendrore të FSSh-së.

BARAZIMET ME INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PRIVATE

Komisioni për Barazime Financiare ndërmjet FSSh-së dhe Institucioneve Shëndetësore Private brenda dhe jashtë vendit, ka për obligim që të marrë në shikim, kontrollojë, dhe verifikojë tërë dokumentacionin në lidhje me secilën kërkesë individuale për programin TMJISHP, pavarësisht vendit ose kohës së realizimit të kërkesës. Dokumentacioni i pranuar verifikohet kundrejt të dhënave dhe informatave që komisioni ka në dispozicion dhe/ose do të pranoj nga ISHP-të brenda dhe jashtë vendit.

Procesi i barazimeve me Institucionet Private Shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit, përfaqëson një aktivitet sfidues për Fondin. Sfidat kryesore të këtij procesi lidhen me periudhën e gjatë që mbulon procesi i barazimeve, mungesën e mekanizmave ligjor detyrues për palët e përfshira në programin për TMJISHP, si dhe vështirësitë e vazhdueshme në kthimin e mjeteve të lira të identifikuar.

Procesi i barazimeve vazhdon deri në përmbylljen e barazimeve me të gjitha institucionet shëndetësore ku shtetasit e Kosovës kanë marrë shërbimet e nevojshme shëndetësore. Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë barazuar 2 institucione shëndetësore private me 255 transaksione në shumën **1,731,835€** dhe vlera e mjeteve të lira të dala nga ky proces është **261,081.61€**.

Tabela 6. Institucionet Shëndetësore Private me të cilat FSSH ka përfunduar barazimet financiare:

Nr.	Institucioni Shëndetësor Privat	Nr. i shërbimeve	Vlera totale e pagesave (€)	Vlera e mjeteve të lira (€)
1	SPITALI AMERICAN - TIRANË	197	1,639,895	257,956
2	INTERNATIONAL HOSPITAL -TIRANË	58	91,940	3,126
Gjithsej		255	€ 1,731,835	€ 261,082.00

Pas pranimit të raportit, menaxhmenti i FSSH-së ka iniciuar shkresa drejtuar institucioneve shëndetësore private me kërkesa për kthimin e mjeteve të lira ne Llogarinë Kryesore - BK, me ç'rast në fund të vitit 2024 është realizuar kthimi i mjeteve të lira në vlerë totale prej **661,072.00€**. Nga kjo vlerë, **640,509.00€** janë mjete të kthyera nga dy ISHP e lartëcekura për raportet e barazimeve të realizuara në vitin 2023 dhe 2024, ndërsa vlera prej **20,563.00€** janë mjete të kthyera nga 7 (shtatë) ISHP me të cilat Fondi kishte realizuar barazim financiar para vitit 2024.

SHËRBIMET E INFORMACIONIT

FSSH gjatë vitit 2024 ka filluar publikimin e rregullt periodik të të dhënave për Programin për TMJISHP. Po ashtu, Divizioni i Shërbimeve të Informacionit, gjatë kësaj periudhe ka realizuar aktivitete që kryesisht lidhen me përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e raporteve/dokumenteve për nevojat e FSSH-së dhe sektorit të shëndetësisë, përfshirë këtu konsolidimin, analizën dhe përgatitjen e raporteve përkatëse.

SFIDAT

Implemetimi i sigurimeve shëndetësore është projekt multisektorial, funksionalizimi i të cilit varet nga shumë hisedarë. Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor, i miratuar me datë 05/12/24 parasheh kompletimin e infrastrukturës ligjore përmes një numri të madh të akteve nënligjore të cilat pritet të hartohen dhe që janë parakusht për fillimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor.

Sa i përket infrastrukturës së teknologjisë informative, përkundër që FSSH në vitin 2024 ka marrë hapa konkret në digjitalizimin e procesit administrativ dhe vendimarrës të Programit për TMJIShP, pos kapaciteteve të personelit të TI, sfiduese për FSSH vazhdon të mbetet:

- ❖ Buxheti i pamjaftueshëm në raport me nevojat reale për programin e TMJIShP;
- ❖ Ngritja e kapaciteteve njerëzore;
- ❖ Vonesat në plotësim/ndryshimin e UA 03/2023 për TMJIShP;
- ❖ Vonesa në digjitalizimin e Programit për TMJIShP;
- ❖ Mungesa e mirëmbajtjes së sistemit të informimit të FSSH-së;
- ❖ Obligimet e akumuluar ndërr vite si rezultat i buxhetit të kufizuar.